



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 nëntor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Njoftimin e Gjashtë të Mbrojtjes së Thaçit të Informacionit Shtesë
për Dëshmitarët dhe Kërkesat në lidhje me Të (F03534)**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 40(2) dhe (6), dhe 58 të Ligjit nr. 05/L--053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 104(5)(c), 107, 116(1) dhe (4), 119(2) dhe (5), 138 dhe 154 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 shtator 2025, Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtjen e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit"), ndër të tjera, të paraqiste përmbledhjet ose deklaratat e dëshmitarëve të mbetur dhe të dorëzonte çdo mocion tjetër të rregullës 107 sa më shpejt që të ishte e mundur, por jo më vonë se tri javë përpara dëshmisë së planifikuar të dëshmitarit përkatës.¹
2. Më 22 tetor 2025, pas njoftimit paraprak për ndryshime në lidhje me dëshmitarë dhe aspekte përkatëse,² Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një njoftim lidhur me informacionin e dëshmitarit 1DW-007 ("Kërkesa").³
3. Më 28 tetor 2025, në vijim të urdhrit për përshpejtimin e afateve,⁴ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Kërkesës.⁵

¹ F03435, Trupi Gjykues, *Urdhër i Mëtejshëm për Planifikimin e Paraqitjes së Provave të Mbrojtjes*, 2 shtator 2025 ("Urdhri i 2 Shtatorit 2025"), para. 10, 15, 35(a) dhe (b).

² F03516, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshime në lidhje me Dëshmitarë*, 10 tetor 2025.

³ F03534, Mbrojtja, *Njoftimi i Gjashtë i Mbrojtjes së Thaçit i Informacionit Shtesë për Dëshmitarë dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 22 tetor 2025, me Shtojcat 1-3, konfidenciale.

⁴ CRSPD926, *Mesazh Elektronik (email) prej Trupit Gjykues drejtuar Palëve, Pjesëmarrësve në lidhje me Përshpejtimin e Afateve për F03534*, 22 tetor 2025.

⁵ F03544, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Njoftimit të Gjashtë të Mbrojtjes së Thaçit të Informacionit Shtesë për Dëshmitarë dhe Kërkesat në lidhje me Të (F03534) ("Përgjigja e ZPS-së")*, 27 tetor 2025, me Shtojcën 1, konfidenciale.

4. Ekipet e Mbrojtjes së Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit (përkatësisht, "Mbrojtja e Selimit", Mbrojtja e Krasniqit" dhe "Mbrojtja e Veselit") u përgjigjën më 29 tetor 2025.⁶

5. Më 31 tetor 2025, në vijim të urdhrimit të Trupit Gjykses,⁷ Mbrojtja e Thaçit dorëzoi listën e ndryshuar të provave materiale.⁸

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja e Thaçit parashtron se, pasi mori autorizim nga autoritetet përkatëse ("dhënësi i informacionit sipas rregullës 107") për dhënien e dëshmisë nga 1DW-007,⁹ nxori deklaratën e dëshmitarit ("Deklarata e 1DW-007-ës")¹⁰ dhe paraqiti informacionin e kërkuar sipas rregullës 119(2)¹¹ dhe paragrafit 74 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Procesit.¹²

7. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit i kërkon Trupit Gjykses: (i) të autorizojë përfshirjen e Deklaratës së 1DW-007-ës në Listën e Provave Materiale;¹³ dhe (ii) të pranojë si provë Deklaratën e 1DW-007-ës sipas rregullave 138 dhe 154.¹⁴ Mbrojtja

⁶ F03548, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Njoftimit të Gjashtë të Mbrojtjes së Thaçit të Informacionit Shtesë për Dëshmitarë dhe Kërkesat në lidhje me Të (F03534)* ("Përgjigjja e Selimit"), 29 tetor 2025; F03549, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Njoftimit të Gjashtë të Mbrojtjes së Thaçit të Informacionit Shtesë për Dëshmitarë dhe Kërkesat në lidhje me Të (F03534)* ("Përgjigjja e Krasniqit"), 29 tetor 2025; F03550, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Njoftimit të Gjashtë të Mbrojtjes së Thaçit të Informacionit Shtesë për Dëshmitarë dhe Kërkesat në lidhje me Të (F03534)* ("Përgjigjja e Veselit"), 29 tetor 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁷ F03546, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mëtejshme të Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale*, 28 tetor 2025, para. 23(b).

⁸ F03553, Mbrojtja, *Parashtrim prej Mbrojtjes së Thaçit i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale*, 31 tetor 2025, me Shtojcën 1, konfidenciale. Trupi Gjykses i referohet listës së provave materiale të 31 tetorit 2025 si "Lista e Provave Materiale".

⁹ Kërkesa, para. 1, 4.

¹⁰ Kërkesa, para. 5. Trupi Gjykses vë në dukje se deklarata e 1DW-007-ës është nxjerrë me ERN-në: DHT12546-DHT12556 në Paketën 1810 të materialit të nxjerrë, *shih* Kërkesën, para. 5 dhe poshtëshënimi 2.

¹¹ Kërkesa, para. 5; Shtojca 1 e Kërkesës.

¹² Kërkesa, para. 5; Shtojca 2 e Kërkesës.

¹³ Kërkesa, para. 1(iii); 7-9, 21(iii).

¹⁴ Kërkesa, para. 1(iii), 10-14, 21(iv).

e Thaçit gjithashtu i kërkon Trupit Gjykses të miratojë disa masa të domosdoshme dhe proporcionale sipas rregullës 107 për mundësimin e dhënës së dëshmisë nga 1DW-007 në sallën e gjyqit.¹⁵ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit i kërkon Trupit Gjykses të shtojë datën 21 nëntor 2025 në kalendar për bllokun vijues të dëshmive nga 17 deri më 20 nëntor 2025,¹⁶ për shkak se synon ta thërrasë 1DW-007-ën si dëshmitar të fundit atë javë.¹⁷

8. Mbrojtja e Thaçit më tej bën të ditur se, me Kërkesën, ka përmbushur detyrimin e vet për paraqitjen e të gjitha mocioneve përkatëse jo më vonë se tri javë përpara dëshmisë së prishme të këtij dëshmitari¹⁸ dhe kërkon që Trupi Gjykses ta marrë parasysh këtë.¹⁹

9. ZPS-ja përgjigjet se, në parim, nuk e kundërshton Kërkesën dhe bën të ditur vlerësimin e kohës që i nevojitet për marrje në pyetje.²⁰

10. Ekipet e Mbrojtjes së të akuzuarve të tjerë përgjigjen se nuk e kundërshtojnë Kërkesën dhe bëjnë të ditur vlerësimin e kohës që i nevojitet secilit prej tyre për marrjen në pyetje të 1DW-007-ës.²¹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Trupi Gjykses përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse të shtjelluara në vendimet e veta të mëparshme në lidhje me: (i) ndryshimin e listës

¹⁵ Kërkesa, para. 1(iv), 15-20, 21(v).

¹⁶ Kërkesa, para. 2, 21(ii).

¹⁷ Kërkesa, para. 2.

¹⁸ Kërkesa, para. 3.

¹⁹ Kërkesa, para. 21(i).

²⁰ Përgjigja e ZPS-së, para. 7; Shtojca 1 e Përgjigjes së ZPS-së, f. 2.

²¹ Përgjigja e Selimit, para. 1; Përgjigja e Krasniqit, para. 2; dhe (iii) Shtojca 1 e Përgjigjes së Veselit.

së provave materiale;²² (ii) masat sipas rregullës 107;²³ dhe (iii) pranimin e provave sipas rregullës 154.²⁴

IV. DISKUTIM

A. KËRKESA PËR NDRYSHIMIN E LISTËS SË PROVAVE MATERIALE

12. Mbrojtja e Thaçit kërkon leje për të përfshirë Deklaratën e 1DW-007-ës në Listën e Provave Materiale të saj.²⁵ Mbrojtja e Thaçit parashtron se kërkesa është bërë në kohë, duke qenë se u paraqit menjëherë pasi mori autorizim prej dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 për dhënien e dëshmisë prej 1DW-007-ës dhe nxori deklaratën e dëshmitarit për palët dhe pjesëmarrësit.²⁶ Mbrojtja e Thaçit gjithashtu parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për përfshirjen e këtij materiali në Listën e Provave Materiale për arsye se përmban prova që kanë vlerë provuese dhe relevancë lidhur me temat në këtë proces.²⁷ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit parashtron se nuk shkaktohet dëm prej përfshirjes së Deklaratës së 1DW-007-ës në Listën e Provave Materiale sepse kërkesa përputhet me qasjen e Trupit Gjykses në lidhje me tema të ngjashme në këtë proces.²⁸

²² *Shih në veçanti*, F01995, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale*, 8 dhjetor 2023, konfidencial, para. 9 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F01995/RED); F02167, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale (F02099)*, 7 mars 2024, konfidencial, para. 10 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F02167/RED); F02501, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale (F02279) dhe mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Mospranimin e Materialeve in Limine*, 22 gusht 2024, konfidencial, para. 23 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 20 dhjetor 2024, F02501/RED; F03457, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale*, 10 shtator 2025, para. 11.

²³ F03468, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Masa sipas Rregullës 107 për Dëshmitarët 1DW-003, 1DW-004, 1DW-005 dhe 1DW-006* (Vendimi i 12 Shtatorit 2025 sipas Rregullës 107"), 12 shtator 2025, konfidencial, para. 12-17.

²⁴ F01380, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Dymbëdhjetë Dëshmitarëve të Parë të ZPS-së sipas Rregullës 154*, 16 mars 2023, konfidencial, para. 26-35 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 7 nëntor 2023, F01380/RED).

²⁵ *Shih më lart*, para. 6.

²⁶ Kërkesa, para. 7.

²⁷ Kërkesa, para. 8.

²⁸ Kërkesa, para. 9.

13. ZPS-ja dhe ekipet e tjera të Mbrojtjes nuk kundërshtojnë kërkesën për ndryshimin e Listës së Provave Materiale.²⁹

14. Sa i përket njoftimit në kohë, Trupi Gjykes vë në dukje parashtrimin e Mbrojtjes së Thaçit se kërkesa u bë sa më shpejt që ishte e mundur pasi dhënisi i informacionit sipas rregullës 107 autorizoi dëshmitarin për të dëshmuar. Pas kësaj Mbrojtja e Thaçit ndërmoi hapa për të rikonfirmuar disponueshmërinë e dëshmitarit dhe për nënshkrimin e Deklaratës së 1DW-007-ës, të cilën e nxori menjëherë për palët dhe pjesëmarrësit.³⁰ Mbrojtja e Thaçit e bëri Kërkesën një ditë pas kësaj nxjerrjeje.³¹ Trupi Gjykes gjithashtu vë në dukje se Kërkesa u bë tri javë para dëshmisë së planifikuar të dëshmitarit, në përputhje me udhëzimet e Trupit Gjykes.³² Rrjedhimisht, Trupi Gjykes është bindur se Mbrojtja e Thaçit ka njoftuar në kohë në lidhje me Deklaratën e 1DW-007-ës.

15. Sa u përket arsyeve të vlefshme, relevancës dhe rëndësisë së mjaftueshme *prima facie*, Trupi Gjykes kujton se qëllimi kryesor i listës së provave materiale është të njoftohet ZPS-ja, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë lidhur me dokumentet që Mbrojtja e Thaçit synon të përdorë gjatë paraqitjes së provave të veta.³³ Në këtë rast, Mbrojtja e Thaçit kërkon përfshirjen e Deklaratës së 1DW-007-ës në Listën e Provave Materiale dhe pranimin e saj sipas rregullës 154, në mënyrë që ta përdorë këtë deklaratë gjatë dhënies së dëshmisë nga 1DW-007.³⁴ Në këtë aspekt, Trupi Gjykes gjithashtu vë në dukje pretendimin e Mbrojtjes së Thaçit se Deklarata e 1DW-007-ës ka lidhje me provat për kontekstin dhe provat që mund të jenë shfajësuese.³⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykes thekson se ZPS-ja dhe ekipet e tjera të

²⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 3, 7; Përgjigjja e Selimit, para. 3; Përgjigjja e Krasniqit, para. 1; Përgjigjja e Veselit, para. 3.

³⁰ Kërkesa, para. 7.

³¹ Paketa 1810 e materialit të nxjerrë, 21 tetor 2025, *contra* Përgjigjja e ZPS-së, 22 tetor 2025.

³² Urdhri i 2 Shtatorit 2025, para. 10, 35(a).

³³ *Shih* F03457, Trupi Gjykes, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale*, 10 shtator 2025, para. 12.

³⁴ Kërkesa, para. 8.

³⁵ Kërkesa, para. 8-9, 12.

Mbrojtjes nuk kundërshtojnë përfshirjen e Deklaratës së 1DW-007-ës në Listën e Provave Materiale.³⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ekzistojnë arsye të vlefshme për ndryshimin e Listës së Provave Materiale për të përfshirë Deklaratën e 1DW-007-ës dhe se kjo deklaratë është relevante *prima facie* dhe me rëndësi të mjaftueshme për të përligjur përfshirjen me vonesë të saj në të.

16. Sa i përket efektit dëmtues, Trupi Gjykses kujton se: (i) Kërkesa u dorëzua menjëherë pas nxjerrjes së Deklaratës së 1DW-007-ës për palët dhe pjesëmarrësit;³⁷ (ii) Deklarata e 1DW-007-ës është e shkurtër, 11 faqe;³⁸ dhe (iv) Kërkesa u dorëzua përpara datës së planifikuar për dhënien e dëshmisë prej 1DW-007-ës.³⁹ Rrjedhimisht, palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë nuk u shkaktohet dëm nga përfshirja e deklaratës së 1DW-007-ës në Listën e Provave Materiale.

17. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton përfshirjen e Deklaratës së 1DW-007-ës në Listën e Provave Materiale. Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë Listën e Ndryshuar të Provave Materiale të saj deri **të martën, 11 nëntor 2025**.

B. KËRKESA PËR PRANIMIN E PROVAVE SIPAS RREGULLËS 154

18. Mbrojtja e Thaçit kërkon pranimin e Deklaratës së 1DW-007-ës⁴⁰ sipas rregullave 138 dhe 154.⁴¹ Mbrojtja e Thaçit parashton se Deklarata e 1DW-007-ës përmbush kriteret përkatëse për t'u pranuar si provë sipas rregullave 138 dhe 154,⁴² për arsye se është relevante,⁴³ autentike dhe mund të mbështetesh në të *prima facie*,⁴⁴ dhe ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues nga pranimi i

³⁶ *Shih më lart*, para. 13.

³⁷ *Shih më lart*, para. 14.

³⁸ DHT12546-DHT12556.

³⁹ *Shih më lart*, para.14.

⁴⁰ DHT12546-DHT12556, *shih më lart* poshtëshënimin 11.

⁴¹ *Shih më lart*, para. 6.

⁴² Kërkesa, para. 6, që i referohet Shtojcës 3 të Kërkesës.

⁴³ Kërkesa, para. 10-12.

⁴⁴ Kërkesa, para. 13.

saj.⁴⁵ Mbrojtja e Thaçit nuk paraqet prova materiale shoqëruese për deklaratën e 1DW-007-ës.⁴⁶

19. ZPS-ja përgjigjet se nuk kundërshton pranimin e Deklaratës së 1DW-007-ës, me kusht që të përmbushen kriteret për pranim si provë sipas rregullës 154.⁴⁷ Megjithatë, ZPS-ja parashtron se Deklarata e 1DW-007-ës përfshin prova që shprehin opinion për aspekte thelbësore dhe, për rrjedhojë, Trupi Gjykses duhet të tregojë kujdes gjatë vlerësimit të peshës, në qoftë se ka, që do t'i japë kësaj deklarate.⁴⁸

20. Ekipe të Mbrojtjes të akuzuarve të tjerë përgjigjen se nuk kundërshtojnë pranimin e Deklaratës së 1DW-007-ës.⁴⁹ Mbrojtja e Selimit shton në këtë aspekt se rezervon të drejtën për të kundërshtuar pranimin e dëshmisë së 1DW-007-ës në sallën e gjyqit.⁵⁰

21. Sa i përket relevancës, Trupi Gjykses vë në dukje se 1DW-007 është ish-oficer ushtarak i nivelit të lartë, i cili shërbeu në pozita të ndryshme relevante nga viti 1997 deri në vitin 2000.⁵¹ Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja e Thaçit synon të mbështetet në Deklaratën e 1DW-007-ës në lidhje me: (i) përpjekjet e NATO-s për zbatimin e Marrëveshjes Hollbruk-Milloshëviq të tetorit 1998 dhe Rezolutën 1199 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ("KSKB");⁵² (ii) fushatën ajrore të

⁴⁵ Kërkesa, para. 14.

⁴⁶ Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja e Thaçit parashtron se nuk do t'i paraqesë 1D00241-shin dhe 1D00389-ën si prova materiale shoqëruese (*shih* DHT12546-DHT12556, para. 29-30) për arsye se ato tashmë janë pranuar si prova në këtë proces (*shih* Kërkesën, para. 5, poshtëshënimi 12). Trupi Gjykses vë në dukje se, përveç këtyre dy provave materiale, Shtojca 3 e Kërkesës përfshin edhe dy prova materiale shoqëruese të tjera (*shih* DHT12546-DHT12556, para. 36-37), të cilat Mbrojtja nuk i paraqet për t'u pranuar si prova, konkretisht 1D00096 që është pranuar tashmë në këtë proces dhe DHT10293 (*shih* Shtojcën 3 të Kërkesës).

⁴⁷ Përgjigja e ZPS-së, para. 1, 4, 7.

⁴⁸ Përgjigja e ZPS-së, para. 4.

⁴⁹ Përgjigja e Selimit, para. 2; Përgjigja e Krasniqit, para. 1; Përgjigja e Veselit, para. 3.

⁵⁰ Përgjigja e Selimit, para. 2.

⁵¹ Kërkesa, para. 10.

⁵² DHT12546-DHT12556, para. 8-16.

NATO-s kundër forcave jugosllave;⁵³ (iii) vendosjen e forcave të NATO-s në Kosovë në përputhje me Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake dhe Rezolutën 1244 të KSBK-së dhe përpjekjet e NATO-s për mbikëqyrjen e çmilitarizimit dhe transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK");⁵⁴ (iv) dijeninë dhe të kuptuarit e dëshmitarit për valën e dhunës në Kosovë në verën e vitit 1999;⁵⁵ dhe (v) ndërveprimet e dëshmitarit me UÇK-në dhe përshtypjet e tij për strukturën komanduese të UÇK-së dhe të kuptuarit e rolit dhe përgjegjësiive të z. Thaçi.⁵⁶

22. Pas shqyrtimit të deklaratës së 1DW-007-ës, Trupi Gjykses është bindur se ajo ka të bëjë me elemente kontekstuale dhe rolin e autoritetin e z. Thaçi në UÇK, sikurse perceptohet nga dëshmitari. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata e 1DW-007-ës është relevante për disa fakte dhe rrethana juridikisht thelbësore për akuzat në Aktakuzë.⁵⁷

23. Lidhur me autenticitetin dhe mbështetshmërinë në të *prima facie*, Trupi Gjykses vë në dukje se Deklarata e 1DW-007-ës: (i) ka nënshkrim dhe datë;⁵⁸ (ii) ka emrat e të pranishmëve gjatë intervistës, ndër të cilët përfaqësues të dhënësit të informacionit sipas rregullës 107;⁵⁹ (iii) përfshin të dhënat personale të 1DW-007-ës; dhe (iv) përmban një deklaratë të dëshmitarit ku ai konfirmon se deklarata është e vërtetë, e saktë dhe ishte dhënë vullnetarisht.⁶⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur për autenticitetin *prima facie* të Deklaratës së 1DW-007-ës dhe mbështetshmërinë në të.

⁵³ DHT12546-DHT12556, para. 20-23.

⁵⁴ DHT12546-DHT12556, para. 27-31.

⁵⁵ DHT12546-DHT12556, para. 32-52.

⁵⁶ DHT12546-DHT12556, para. 32-52.

⁵⁷ F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 30 shtator 2022, konfidenciale (versioni publik me më pak redaktime u dorëzua më 27 shkurt 2023, F01323/A01), para. 16-57.

⁵⁸ DHT12546-DHT12556, f. 11.

⁵⁹ DHT12546-DHT12556, f. 1.

⁶⁰ DHT12546-DHT12556, f. 11.

24. Sa i përket vlerës provuese, Trupi Gjykses ka marrë parasysh parashtrimin e ZPS-së se Deklarata e 1DW-007-ës përfshin prova që shprehin opinion për aspekte thelbësore në këtë çështje gjyqësore.⁶¹ Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se prova që shprehin opinion janë paraqitur vazhdimisht në këtë gjykim nga secila palë dhe se Trupi Gjykses nuk i ka trajtuar ato në vetvete si të papranueshme.⁶² Trupi Gjykses do t'i trajtojë me kujdes të veçantë këto prova kur të vlerësojë peshën dhe vlerën provuese të tyre dhe kur të shqyrtojë, në veçanti, ekzistencën dhe llojin e bazës mbi të cilën është krijuar ky opinion, si dhe praninë e çdo konfirmimi të mbështetshmërisë në to.⁶³ Për më tepër, Trupi Gjykses mban parasysh se provat që shprehin opinion mund të mos përdoren për të vërtetuar "aspekte thelbësore",⁶⁴ gjë që është në kompetencën e Trupit Gjykses.⁶⁵ Gjithashtu, ZPS-ja do të ketë mundësi ta marrë në pyetje dëshmitarin në lidhje me çdo aspekt të dëshmisë së tij me të cilin nuk pajtohet. Rrjedhimisht, dhe duke pasur parasysh relevancën, autenticitetin *prima facie* dhe mbështetshmërinë në të, Trupi Gjykses është bindur se Deklarata e 1DW-007-ës ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

25. Sa i përket përshtatshmërisë për t'u pranuar si provë sipas rregullës 154, Trupi Gjykses është bindur se Deklarata e 1DW-007-ës kontribuon në përshejtimin e procesit pasi ka vetëm 11 faqe dhe Mbrojtja e Thaçit parasheh që marrja në pyetje prej saj të mos zgjasë më shumë se tri orë.⁶⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se pranimi i Deklaratës së 1DW-007-ës nuk do t'i dëmtonte palët dhe pjesëmarrësit e tjerë pasi ata: (i) do të kenë mundësi t'i bëjnë pyetje dëshmitarit; dhe (ii) nuk kundërshtojnë Kërkesën.⁶⁷

⁶¹ *Shih më lart*, para. 19.

⁶² Transkripti i seancës, 5 shtator 2023 ("Transkripti i 5 shtatorit 2023"), f. 7280, rreshtat 11-13.

⁶³ Transkripti i 5 shtatorit 2023, f. 7280, rreshtat 23-25.

⁶⁴ Transkripti i 5 shtatorit 2023, f. 7280, rreshtat 18-22.

⁶⁵ Transkripti i 5 shtatorit 2023, f. 7280, rreshtat 21-22.

⁶⁶ *Shih* Kërkesën, para. 14; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 1; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 1.

⁶⁷ *Shih më lart*, para. 20.

26. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se Deklarata e 1DW-007 është e përshtatshme për t'u pranuar si provë sipas rregullave 138(1) dhe 154 pas përmbushjes së kritereve të rregullës 154(a)-(c).

C. KËRKESA PËR MASA SIPAS RREGULLËS 107

27. Mbrojtja e Thaçit kërkon disa masa në sallën e gjyqit në lidhje me të cilat dhënësi i informacionit sipas rregullës 107 ka kushtëzuar dhënien e dëshmisë prej 1DW-007-ës.⁶⁸ Mbrojtja e Thaçit parashton se këto masa janë të ligjshme dhe të arsyeshme për shkak se ato janë të përshtatshme dhe në përputhje me rregullën 107.⁶⁹ Ajo gjithashtu parashton se këto masa nuk u shkaktojnë dëm palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë⁷⁰ dhe prania e dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 është e favorshme për zgjidhjen në kohë të çdo problemi që lidhet me kuadrin e lejueshëm të dëshmisë së 1DW-007-ës.⁷¹

28. ZPS-ja përgjigjet se nuk kundërshton masat sipas rregullës 107 për 1DW-007-ën me marrëveshjen që palët kundërshtare mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit mbi aspekte: (i) që rrjedhin nga Deklarata e 1DW-007-ës dhe marrja në pyetje e tij nga pala thirrëse; dhe (ii) lidhur me besueshmërinë, përfshirë aspekte përtej kuadrit të kufizuar të substancës së dëshmisë të përcaktuara në Kërkesë.⁷²

29. Ekipet e Mbrojtjes të të akuzuarve të tjerë nuk kundërshtojnë masat sipas rregullës 107.⁷³

30. Trupi Gjykses kujton se: (i) rregulla 107 vlen *mutatis mutandis* për informacionin nën ruajtjen apo kontrollin e Mbrojtjes;⁷⁴ dhe (ii) rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të vlerësojë nëse masat e kërkuara nga Mbrojtja e Thaçit janë të

⁶⁸ *Shih më lart*, para. 6.

⁶⁹ Kërkesa, para. 19.

⁷⁰ Kërkesa, para. 19.

⁷¹ Kërkesa, para. 20.

⁷² Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 5, 6.

⁷³ *Shih më lart*, para. 10.

⁷⁴ Vendimi i 12 Shtatorit 2025 sipas Rregullës 107, para. 17.

domosdoshme dhe proporcionale dhe nëse, sipas rregullës 107(5), e drejta e palëve kundërshtare për të kundërshtuar provat mbetet e pandikuar.⁷⁵

31. Trupi Gjykues vë në dukje se 1DW-007 ka qenë i punësuar nga dhënësi i informacionit sipas rregullës 107,⁷⁶ dhe ka autorizim të kushtëzuar për të dëshmuar në këtë proces, bazuar në përmbajtjen e deklaratës së tij dhe në varësi të disa masave.⁷⁷ Këto masa janë: (i) kuadri i dëshmisë së dëshmitarit kufizohet në tema të përcaktuara, si: angazhimet e tij në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, sikurse pasqyrohet në deklaratën e dëshmitarit, vëzhgimet dhe angazhimet e dëshmitarit në Konferencën e Rambujesë, pasojat e saj dhe roli i UÇK-së dhe i z. Thaçi, çmilitarizimi i UÇK-së pas luftës, takimet dhe bisedat e dëshmitarit me z. Thaçi, dijeninë e tij për strukturën dhe organizimin e UÇK-së, vëzhgimet e tij lidhur me shkallën e kontrollit të UÇK-së prej z. Thaçi, përshtypjet e tij lidhur me komandën dhe kontrollin e UÇK-së, dijeninë e tij për veprimet e dhunës në Kosovë prej forcave serbe dhe shqiptarëve të Kosovës dhe pikëpamjet e tij lidhur me aftësinë e UÇK-së, komandantëve të saj dhe z. Thaçi për të parandaluar veprimet e dhunës ("masa e parë");⁷⁸ (ii) kuadri i marrjes në pyetje nga pala kundërshtare kufizohet në kuadrin e marrjes në pyetje nga pala thirrëse, si dhe në aspekte lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit ("masa e dytë");⁷⁹ (iii) dëshmitari mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve për arsye konfidencialiteti ("masa e tretë");⁸⁰ (iv) përfaqësues të dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 autorizohen të jenë të pranishëm gjatë dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit ("masa e katërt");⁸¹ dhe (v) dëshmitari nuk autorizohet të japë dëshmi, as gjatë pyetjeve të palës thirrëse, as të palës

⁷⁵ Vendimi i 12 Shtatorit 2025 sipas Rregullës 107, para. 17.

⁷⁶ Kërkesa, para. 10; Shtojca 1 e Kërkesës para. 1; Shtojca 2 e Kërkesës, para. 1.

⁷⁷ Trupi Gjykues vë në dukje informacionin e Mbrojtjes së Thaçit se provat e 1DW-007-ës fillimisht iu dhanë nga dhënësi i informacionit sipas rregullës 107 në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për qëllim informimi dhe konteksti, me mirëkuptimin se do të zbatohet rregulla 107. *Shih* Kërkesën, para. 15.

⁷⁸ Kërkesa, para. 16, 21(v)(a).

⁷⁹ Kërkesa, para. 17(i), 21(v)(b).

⁸⁰ Kërkesa, para. 17(ii), 21(v)(c).

⁸¹ Kërkesa, para. 17(iii), 21(v)(c).

kundërshtare, për ndonjë aspekt apo qëllim tjetër përveç atyre të specifikuar në masën e parë, të dytë dhe të tretë ("masa e pestë" dhe së bashku "masat").⁸²

32. Lidhur me masën e parë, të dytë dhe të tretë, që kanë të bëjnë me përmbajtjen ose kuadrin e dëshmisë së dëshmitarit, Trupi Gjykes vë në dukje se, në bazë të rregullës 107(3) dhe (4), ai as nuk mund ta detyrojë një dëshmitar t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me informacionin ose burimin e informacionit në qoftë se dëshmitari refuzon të përgjigjet për arsye konfidencialiteti as nuk mund të urdhërojë paraqitjen e provave të tjera shtesë përveç atyre të autorizuara nga dhënësi i informacionit sipas rregullës 107.⁸³ Trupi Gjykes kujton se arsyeja e ekzistencës së rregullës 107 është "krijimi i motivit për një bashkëpunim të tillë duke lejuar shkëmbimin e informacionit mbi bazë konfidenciale dhe duke u garantuar dhënësve të informacionit se do të mbrohet konfidencialiteti i informacionit që ata ofrojnë dhe i burimit i tij".⁸⁴ Trupi Gjykes gjithashtu thekson se Deklarata e 1DW-007-ës është relevante për këtë proces dhe mund ta ndihmojë Trupin Gjykes në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave relevante për këtë çështje gjyqësore.⁸⁵ Për këto arsye, Trupi Gjykes është bindur se masa e parë, e dytë, e tretë dhe e pestë janë në përputhje me rregullën 107(3)-(5) dhe janë mënyrë e përshtatshme për zbatimin e saj. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes është bindur se masa e parë, e dytë, e tretë dhe e pestë janë të domosdoshme.

33. Sa i përket proporcionalitetit të masës së parë, të dytë, të tretë dhe të pestë, Trupi Gjykes vëren se masat përcaktojnë shprehimisht se palët mund ta marrin në pyetje 1DW-007-ën vetëm për aspekte që kanë lidhje me besueshmërinë.⁸⁶ Trupi Gjykes gjithashtu mban parasysh se kufizimet e vendosura nga dhënësi i informacionit sipas rregullës 107 mbrojnë në mënyrë efektive interesat e dhënësit

⁸² Kërkesa, para. 18.

⁸³ Vendimi i 12 Shtatorit 2025 sipas Rregullës 107, para. 21.

⁸⁴ Vendimi i 12 Shtatorit 2025 sipas Rregullës 107, para. 21 me referenca të mëtejshme.

⁸⁵ Kërkesa, para. 10, 15; Shtojca 1 dhe 2 e Kërkesës.

⁸⁶ Kërkesa, para. 17(i). *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 3.

të informacionit sipas rregullës 107 dhe janë në përputhje me të drejtat dhe interesat e palëve kundërshtare. Nëse lind ndonjë problem lidhur me kuadrin e lejuar të pyetjeve për dëshmitarin, përfaqësuesit e dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 do të jenë të pranishëm në sallën e gjyqit dhe mund t'ia paraqesin këto probleme Trupit Gjykses.⁸⁷ Bazuar në këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se kufizimet e propozuara nga dhënësi i informacionit sipas rregullës 107 lidhur me kuadrin e dëshmisë së 1DW-007-ës nuk shkelin të drejtat e palëve kundërshtare për të kundërshtuar dëshminë e tij. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se masa e parë, e dytë, e tretë dhe e pestë janë proporcionale.

34. Sa i përket masës së katërt, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Thaçit mund të mos jetë e informuar plotësisht për të identifikuar pyetjet që mund të dëmtojnë interesat e ndjeshme të dhënësit të informacionit sipas rregullës 107. Rrjedhimisht, është e nevojshme që përfaqësuesit e dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 të jenë të pranishëm në sallën e gjyqit për t'i identifikuar këto probleme dhe për t'ia paraqitur ato Trupit Gjykses në rastin kur një problem lidhur me konfidencialitetin apo shqetësime të tjera mund të kërkojnë ndërhyrjen e Trupit Gjykses. Trupi Gjykses konstaton se asnjë masë më pak kufizuese nuk do të trajtonte mjaftueshëm shqetësimet lidhur me dëshminë e propozuar të 1DW-007-ës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se masa e katërt është e domosdoshme.

35. Sa i përket proporcionalitetit të masës së katërt, Trupi Gjykses vë në dukje se palët dhe pjesëmarrësit e tjerë nuk kundërshtojnë praninë e përfaqësuesve të dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 gjatë dhënies së dëshmisë prej 1DW-007-ës. Trupi Gjykses konstaton se prania e përfaqësuesve të dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 mund të ndihmojë për zgjidhjen e çdo problemi lidhur me kuadrin e pyetjeve të lejueshme, ose përdorimin e dokumenteve me dëshmitarin. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se masa e katërt mbron në

⁸⁷ *Shih më poshtë*, para. 34-35.

mënyrë efektive interesat e dhënësit të informacionit sipas rregullës 107 dhe përputhet me të drejtat dhe interesat e palëve kundërshtare. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se masa e katërt është proporcionale.

36. Bazuar në këto arsye, Trupi Gjykses autorizon masat.

D. KËRKESA PËR SEANCË GJYQËSORE MË 21 NËNTOR 2025

37. Mbrojtja e Thaçit kërkon që Trupi Gjykses t'i shtojë 21 nëntorin 2025 ditëve të rezervuara tashmë nga Trupi Gjykses për seanca gjyqësore nga 17 deri më 20 nëntor 2025.⁸⁸

38. Trupi Gjykses është informuar se 1DW-007 mund ta fillojë dhënien e dëshmisë së tij vetëm pasditen e 18 nëntorit 2025, ose paraditen e 19 nëntorit 2025.⁸⁹

Pasi shqyrtoi vlerësimin e palëve lidhur me dëshminë e këtij dëshmitari,⁹⁰ Trupi Gjykses e gjykon të arsyeshme të rezervojë një seancë gjyqësore shtesë më 21 nëntor 2025, për të përfunduar dhënia e dëshmisë prej 1DW-007-ës dhe urdhëron Zyrën Administrative të bëjë përgatitjet e nevojshme për këtë. Gjithsesi, Trupi Gjykses vë në dukje se, deri më sot, marrja në pyetje e dëshmitarëve të Mbrojtjes ka zgjatur më pak se sa u vlerësua fillimisht. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje, edhe një herë, se Mbrojtja e Thaçit në mënyrë të përsëritur ka shkelur urdhrin e Trupit Gjykses që dëshmitarët duhet të thirren njëri pas tjetrit dhe pa ndërprerje në kalendar. Si pasojë e mosrespektimit të kësaj praktike nga Mbrojtja e Thaçit, janë anuluar javë të tëra të seancave gjyqësore. Pavarësisht nga sa më lart, dhe për të siguruar mbylljen e shpejt dhe efektive të paraqitjes së provave prej Mbrojtjes, Trupi Gjykses do ta planifikojë 21 nëntorin 2025 si ditë paraprake për seancë

⁸⁸ *Shih më lart*, para. 6.

⁸⁹ Kërkesa, para. 2.

⁹⁰ Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) Mbrojtja e Thaçit vlerëson se koha që i nevojitet për marrje në pyetje do të zgjasë deri në tri orë (*shih më lart*, para. 25); (ii) ZPS-ja vlerëson se koha që i nevojitet për marrje në pyetje do të zgjasë deri në katër orë (*shih Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së, f.2*); (iii) Mbrojtja e Selimit vlerëson se koha që i nevojitet për marrje në pyetje do të zgjasë deri në 30 minuta (*shih Përgjigjen e Selimit, para. 1*); (iv) Mbrojtja e Krasniqit vlerëson se koha që i nevojitet për marrje në pyetje do të zgjasë deri në 45 minuta (*shih Përgjigjen e Krasniqit, para. 2*); dhe (v) Mbrojtja e Veselit vlerëson se koha që i nevojitet për marrje në pyetje do të zgjasë deri në 30 minuta (*shih Shtojcën 1 të Përgjigjes së Veselit*).

gjqësore. Megjithatë, palët duhet të përpiqen të përfundojnë marrjen në pyetje të 1DW-007-ës brenda kësaj date dhe marrjen në pyetje ta bëjnë ekskluzivisht për aspekte që janë vërtet relevante për këtë çështje gjyqësore.

E. NJOFTIMI I DËSHMITARIT

39. Mbrojtja e Thaçit i kërkon Trupit Gjyqësor që të ketë parasysh njoftimin e dëshmitarit⁹¹ dhe Trupi Gjyqësor e bën këtë.

F. KLASIFIKIMI

40. Trupi Gjyqësor vë në dukje se Mbrojtja e Veselit i ka dorëzuar përgjigjen e vet ndaj Kërkesës dhe shtojcën e saj, parashtrimet F03550 dhe F03550/A01, si konfidenciale dhe nuk kundërshton riklasifikimin e tyre si publike.⁹² ZPS-ja dhe ekipet e tjera të Mbrojtjes i kanë dorëzuar parashtrimet përkatëse të tyre si publike.

41. Trupi Gjyqësor urdhëron Administratoren të riklasifikojë parashtrimet F03550 dhe F03550/A01 si publike.

V. VENDIM

42. Për këto arsye, Trupi Gjyqësor:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **KA PARASYSH** njoftimin e dëshmitarit;
- c) **I MIRATON** Mbrojtjes së Thaçit leje për ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe **E URDHËRON** ta dorëzojë Listën e Provave Materiale të Ndryshuar deri të **martën, 11 nëntor 2025**;
- d) **KONSTATON** se Deklarata e 1DW-007-ës është e përshtatshme për t'u pranuar si provë në varësi të përmbushjes së kriterëve të rregullës 154(a)-

⁹¹ *Shih më lart*, para. 8.

⁹² Përgjigja e Veselit, para. 4.

